

E DREJTA PËR INFORMIM

Së bashku për një administratë transparente dhe me integritet

Llogaridhënia dhe integriteti në veprimtarinë e administratës publike janë thelbësore për forcimin e kulturës së transparencës përballë qytetarëve. Me rastin e 28 Shtatorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, Zyra e Komisionerit zhvilloi në mjediset e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil një aktivitet informues e ndërgjegjësues.



Legjislacioni për të drejtën e informimit, ashtu si edhe ai për shërbimin civil, kanë për qëllim të ndikojnë në formësimin e një administrate publike të përgjegjshme dhe profesionale, për të ofruar shërbime cilësore duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i eksperiencave mes nëpunësve, njohja me praktikën më të mira respektive dhe ngjashmëritë apo pikat e përbashkëta të kuadrit rregullator në ushtrimin e përgjegjësisë sipas fushave të veprimtarisë. Një nga çështjet kryesore të diskutuara në këtë takim ishte publikimi i informacionit/dokumentacionit, që ka të bëjë me vendimmarrjen e autoriteteve publike në kuadër të transparencës proaktive, ashtu si edhe konsolidimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit brenda strukturave institucionale.



Vëmendje iu kushtua, zbatimit me korrektësi të legjislacionit për shërbimin civil në trajtimin me balancë dhe proporcionalitet të të drejtës për informim dhe asaj për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky bashkëpunim dhe ndërveprim mes stafeve të institucioneve të pavarura siguron një njohje më të zgjeruar të kornizës ligjore dhe procedurave të njëri-tjetrit, për të nxitur përgjegjshmërinë dhe integritetin në ushtrimin e kompetencave institucionale.

Edukim dhe ndërgjegjësim i brezit të ri për ushtrimin e të drejtave

Edukimi i brezit të ri për njohjen dhe ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore është i rëndësishëm për një shoqëri demokratike dhe të zhvilluar. Në kuadër të aktiviteteve me rastin e 28 Shtatorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, Zyra e Komisionerit zhvilloi takime me nxënës e mësues të arsimit 9-vjeçar publik e privat, me moton “Mos ki ndrojtje të pyesësh”.



Takimet kishin si qëllim prezantimin e koncepteve dhe parimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit për këtë grupmoshë dhe rritjen e ndërgjegjësimit në ushtrimin praktik të kësaj të drejte. Stafi i Zyrës së Komisionerit ishte në shkollat 9-vjeçare “E Kuqe” dhe “Independent”, ku ndau me të pranishmit njohuri dhe këshilla praktike, si pjesë e angazhimit konstant të institucionit në bashkëpunimin e tij me strukturat arsimore të vendit. Ata u njohën me elementët kryesore të të drejtës për informim, një historik mbi evoluimin e saj në Shqipëri dhe në botë, si dhe me funksionet dhe veprimtarinë institucionale në promovimin e saj. Këto takime u zhvilluan në formën e një bashkëbisedimi të lirë me pyetje-përgjigje në lëndën e “Qytetarisë”.



KONSULTONI FAQEN WWW.IDP.AL PËR TU NJOHUR ME TË REJAT MË TË FUNDIT TË ZYRËS SË KOMISIONERIT

Mbështetje nga Kuvendi për veprimtarinë e institucioneve të pavarura



Në Kryesinë e Kuvendit u zhvillua [takimi i Kryetares, znj. Elisa Spiropali, me drejtues të institucioneve të pavarura](#). Në këtë aktivitet i pranishëm ishte edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi. Në fjalën e tij z. Dervishi theksoi si shumë të rëndësishëm forcimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimin me Kuvendin, me Komisionet e Përhershme parlamentare dhe me Shërbimin e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura.

“Mendoj se ka mundësi si për ndërhyrje afatgjata, që kërkojnë kohën e domosdoshme të zbatimit, ashtu edhe për ndërhyrje të menjëhershme që përmirësojnë situatën dhe statusin e institucioneve të pavaruara. Ndërmarrja e një iniciative të re, duke u mbështetur në raportet e ekspertëve të BE, besoj se do të ndihmonte shumë jo vetëm në deburokratizimin e disa proceseve të tejkaluara, por do të ndikonte në arritjen nga institucionet e pavaruara të standardeve të BE...”



Gjithashtu, uroj që ky takim, ky forum të zhvillohet jo vetëm në këtë format, por për shembull edhe me grupe të caktuara të institucioneve të pavaruara, fushat e veprimtarisë së të cilave apo natyra e punës së tyre lidhen ngushtësisht me njëra-tjetrën, siç mund të jenë Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, entet rregullatore, etj.” – tha z. Dervishi.

Zbatimi i kuadrit ligjor nga administrata tatimore dhe ajo doganore

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në Ministrinë e Financave zhvilluan një modul trajnimi 2-ditor. Në këtë aktivitet morën pjesë më shumë se 70 nëpunës të nivele dhe strukturave të ndryshme qendrore dhe vendore të këtyre institucioneve, të cilët u njohën me përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit në fuqi për të dy fushat e përgjegjësisë të Zyrës së Komisionerit, rolin e funksionet e institucionit, si dhe zbatimin e këtij kuadri rregullator në raport me veprimtarinë e administratës tatimore dhe asaj doganore.



Vëmendje iu kushtua, nëpërmjet paraqitjes të rasteve konkrete të shqyrtuara nga autoriteti ndër vite, nxitjes dhe forcimit të transparencës proaktive të këtyre institucioneve, trajtimit të dy të drejtave në balancë dhe në proporcionalitet me njëra-tjetrën, apo marrjes së masave të duhura tekniko-organizative për nivel të lartë sigurie në proceset e përpunimit të të dhënave personale. Në optikën e zhvillimeve teknologjike dhe digjitalizimit të shërbimeve, njëkohësisht, kërkohet bashkëpunim e ndërveprim me përgjegjshmëri dhe transparencë me qytetarët apo grupet e interesit, për garantimin e ushtrimit të këtyre të drejtave në praktikë. Përmbushja e detyrimeve ligjore, si në fushën e të drejtës për informim ashtu edhe atyre për mbrojtjen e të dhënave personale, forcon kulturën e integritetit dhe llogaridhënies në ushtrimin e funksioneve të administratës tatimore dhe asaj doganore.

Zyra e Komisionerit mirëpret çdo iniciativë për zhvillimin e trajnimeve të kësaj natyre edhe me institucione të tjera të rëndësishme të administratës shtetërore/publike.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania